



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 30
Prishtinë, më 27. 01. 2010, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini dhe Slobodan Petroviq.

Munguan: Enis Kervan dhe Nexhat Daci.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi, Maria Berishaj e Blerim Vela - OSBE, Rrezarta Ahmeti - KDI, Lumnije Murati - ZPRK dhe Albana Bylykbashi - MPJ.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20 janar 2010;**
- 3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritime Evropiane;**
- 4. Miratimi i Planit dhe Programit të Punës së Komisionit;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratohet rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritime Evropiane;

Sabri Hamiti - I njoftoi anëtarët e Komisionit se është kërkuar nga komisionet parlamentare që ta shqyrtojnë Planin e Veprimit për Integritime Evropiane të Kuvendit dhe vërejtjet eventuale t'i përcillen Komisionit për Integritime Evropiane.

Detyrat e Komisionit, sipas Planit të Veprimit për Integritime Evropiane, janë inkorporuar në Planin e Programin e Punës së Komisionit për këtë vit. Përkrah Planin e Veprimit për Integritime Evropiane të Kuvendit me vërejtjen për mënyrën e hartimit, sepse mendon se është i ngarkuar pa nevojë.

Ardian Gjini - Mendon se në Planin e Veprimit të Kuvendit për Integritime Evropiane është bërë një përshkrim i panevojshëm i punëve.

Pas shqyrtimit të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritime Evropiane, Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni për Punë të Jashtme e përkrah procedimin për miratim në Kuvend të Planit të Veprimit për Integritime Evropiane, me vërejtjen që teksti të hartohet në mënyrë më funksionale.

4. Miratimi i Planit dhe Programit të Punës së Komisionit;

Sabri Hamiti - Lidhur me Planin e Programin e Punës së Komisionit tha se në Draftin e propozuar janë përmbledhur detyrat e Komisionit dhe pikësynimi i qëllimeve kryesore deri në fund të këtij sesioni.

Xhavit Haliti - Propozoi që në Planin dhe Programin e Punës të Komisionit të hyjë edhe çështja e mërgimtarëve, e cila ka mbetur pa u realizuar nga Programi i vitit të kaluar, si dhe përpjekja për organizimin e një Konference rajonale, me kryetarët e komisioneve të jashtme të vendeve të rajonit dhe më gjerë.

Sabri Hamiti - Tha se kjo është një e ide shumë e mirë, të cilën e përkrahim, por paraprakisht duhet zhvilluar biseda dhe marrëveshje së paku me tri - katër vende pjesëmarrëse dhe kërkon kohë të kalohet në pjesën ekzekutive programore të Komisionit.

Ibrahim Gashi – Tha se e përkrah idenë e z. Xh. Halitit, për organizimin e Konferencës rajonale, në të cilën do të mund të diskutoheshin shumë çështje që e preokupojnë Kosovën.

Komisioni pas diskutimeve nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Plani dhe Programi i Punës së Komisionit për periudhën janar- korrik 2010, me plotësimin e pikave:

1. Vizitë mërgatës dhe
2. Organizimi i Konferencës rajonale.

5. Të ndryshme.

Ibrahim Gashi, në cilësi të kryesuesit të grupit punues për P/ligjin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare propozoi që Komisioni ta përkrahë miratimin në parim të këtij projektligji.

Komisioni pas diskutimeve nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni për Punë të Jashtme përkrah miratimin në parim të Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

Mbledhja përfundoi në orën 10: 30

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit